



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 521, datë 24.09.2024**

**PËR**

**CAKTIMIN E RELATORIT NË PROCEDURAT E VERIFIKIMIT TË  
KANCELARËVE NË DETYRË DHE KUALIFIKIMIT DHE VIJIMIN E  
PROCEDURAVE TË EMËRIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË  
KANDIDATËVE QË KANË PËRFUNDUAR PROGRAMIN E FORMIMIT  
FILLESTAR PËR NDIHMËS LIGJOR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,  
VITI AKADEMIK 2023-2024, TË PAPËRFUNDUARA PËR SHKAK TË  
MBARIMIT TË MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË  
GJYQËSOR, ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90 dhe 97, pika 1 shkronja “a”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 55 dhe 83 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424 , datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”; nr.10, datë 14.01.2021 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”; nr. 8, datë 17.01.2022 “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kancelarëve në detyrë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe të posaçëm, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Medi Bici”; nr. 473, datë 07.09.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjor, viti akademik 2023-2024”; vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 362, datë 29.07.2024 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimit të qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Caktimin e znj. Yllka Rupa relatore të procedurave të verifikimit të kancelarëve në detyrë, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë:

- i. znj. {...}
  - ii. z. {...}
2. Caktimin e znj. Yllka Rupa relatores të procedurave të kualifikimit dhe vijimit të procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Fatmira Luli, si më poshtë:
- i. znj. {...};
  - ii. znj. {...}
  - iii. z. {...}
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kancelarëve në detyrë dhe kandidatëve për ndihmës ligjorë sipas pikës 65 të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**